



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Seanca plenare e Kuvendit
P- 84/2
Prishtinë, më 12 tetor 2009
Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 12 DHE 13 TETOR 2009**

Seancën e drejtoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Sabri Hamiti**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 68 deputetë dhe deklaroi të hapur punimet e seancës.

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Nuk pati asnjë propozim për amendimin të rendit të ditës.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d d i t e

1. Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare, të mbajtur më 30. 09. 2009,
 2. Koha për pyetje parlamentare,
 3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për organizimin sindikal,
 4. Shqyrtimi i parë i Projektligji për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale,
 5. Shqyrtimi i Raportit vjetor i Bankës Qendrore të Kosovës,
 6. Shqyrtimi i Projekt-strategjisë kundër korrupsionit,
 7. Debatë për gjendjen tregtare në vend dhe raportet tregtare të Kosovës me shtetet tjera,
 8. Shqyrtimi i Raportit për monitorimin e Ligjit për mbeturina,
 9. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit ad-hoc për emërimin e anëtarëve të Bordit të Radio - Televizionit të Kosovës,
 10. Njoftimi me vendimin e Grupit Parlamentar të AKR-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.
- .

1. Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare, të mbajtur më 30.09. 2009

Kuvendi miratoi pa vërejtje Procesverbalin e seancës plenare, të mbajtur më 30.09. 2009.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti **Riza Smaka**, parashtoi pyetje për ministrin Zenun Pajaziti lidhur me liberalizimin e vizave.

Ministri Pajziti iu përgjigj pyetjes së deputetit Smaka.

Deputetja **Myrvete Pantina**, parashtoi pyetje për zëvendëskryeministrin Hajredin Kuçi lidhur me uzurpimin e pronave shoqërore të privatizuara..

Zëvendës Kryeministri Hajredin Kuçi iu përgjigj pyetjes së deputetes Pantina.

Deputeti **Riza Smaka**, parashtoi pyetje për ministrin Ahmet Shala lidhur me rastet e manipulimeve financiare në institucionet publike, por edhe ato të përziera private.

Ministri Shala iu përgjigj pyetjes së deputetit Smaka.

Deputeti **Riza Smaka**, parashtoi pyetje për ministrin Valton Beqiri lidhur me shprehjet dhe tekstet irituese të niveleve të ulëta me përmbajtje imorale që po përdoren në mediat tona elektronike.

Ministri Beqiri iu përgjigj pyetjes së deputetit Smaka.

Deputeti **Riza Smaka**, parashtoi pyetje për Kryeministrin Hashim Thaçi lidhur me mos ekzistimin e Ministrisë së Diasporës për Republikën e Kosovës.

Zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi iu përgjigj pyetjes së deputetit Smaka.

Deputeti **Riza Smaka**, parashtoi pyetje për Zëvendëskryeministrin Hajredin Kuçi ose Ramë Manaj lidhur me ndërtimin e objekteve sociale ne qytetin e Pejës.

Zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi iu përgjigj pyetjes së deputetit Smaka.

Deputetja **Nerxhivane Dauti**, parashtoi pyetje për zëvendëskryeministrin Ramë Manaj për vonesën e procedimit të Ligjit për detyrimet në Kuvend e Republikës së Kosovës.

Zëvendëskryeministri Manaj iu përgjigj pyetjes së deputetes Dauti.

Deputetja **Qamile Morina**, parashtoi pyetje për ministrin Alush Gashi lidhur me shpenzimet enorme të qytetarëve të Kosovës për barna dhe materiale shpenzuese.

Ministri Gashi iu përgjigj pyetjes së deputetes Morina.

Deputetja **Drstita Maliqi**, parashtoi pyetje për ministrin Sadri Ferati lidhur me pagimin e qirasë për qytetarët e pjesës veriore të Kosovës.

Ministri Ferati iu përgjigj pyetjes së deputetes Maliqi.

Deputetja **Drita Maliqi**, parashtoi pyetje për Kryeministrin Hashim Thaçi lidhur me uzurpimin e banesave të qytetarëve të pjesës veriore të Kosovës.

Zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi iu përgjigj pyetjes së deputetes Maliqi.

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për organizim sindikal

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës që ta prezantojë Projektligjin për organizim sindikal.

Ministri **Nenad Rashiq** tha se ky Projektligj është hartuar me qëllim të rregullimit të organizatave sindikale dhe është në frymën e praktikave më të mira ndërkombëtare nga kjo lëmi ku është i harmonizuar me standardet ndërkombëtare.

Në vazhdim, ai tha se Projektligji rregullon te drejtat e punëtorëve lidhur me anëtarësimin në organizatat sindikale dhe rregullon kushtet optimale për sindikatat. Në fund, ai kërkoi nga deputetët miratimin në parim të këtij projektligji.

Kryetari ftoi kryetarin e Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale që ta marrë fjalën.

Kryetari i Komisionit, **Sadik Idriz**, tha se komisioni ka shqyrtuar këtë projektligj, por në komision nuk kemi arritur një qëndrim unik që ky projektligj të shkojë para Ligjit të punës ose të shkojë në pako me dy ligjet e tjera, Ligjin për punën dhe Ligjin për grevën. Ai theksoi se nëse ky ligj kalon pa kaluar edhe Ligji për punën, atëherë nuk do ta ketë efektin e vet.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtim, në parim, të Projektligjit për organizim sindikal

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Mimoza Ahmetaj**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Nurisha Hula**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Shkumbin Demalijaj**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Rita Hajzeraj**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Qamile Morina**, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar të SLS, **Mursel Halili**, **pastaj ministri i Punës dhe i Mirëqenies Sociale, Nenad Rašić**, si dhe deputetët: **Gjylnaze Sylaj, Bahri Hyseni, Gani Koci, Ardian Gjini dhe Ibrahim Gashi**, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim propozimin e grupeve parlamentare që Projektligji për organizim sindikal të shtyhet për një seancë tjetër. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----30,
Kundër-----27,
Abstenime-----3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash hoqi nga rendi i ditës Projektligjin për organizim sindikal.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës që ta prezantojë Projektligjin për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale.

Ministri **Ahmet Shala**, tha se ky projektligj është pjesë e pakos ligjore, të bazuar në standardet dhe praktikën më të mira të vendeve të Bashkësisë Evropiane dhe të regjionit. Projektligji përcakton procedurat për veprimin e Doganave të Kosovës për mallrat që janë të dyshimta, për shkelje të drejtave të pronës intelektuale, për ato produkte dhe licenca që hyjnë apo dalin nga territori doganor i Republikës së Kosovës. Deri më tani, në Kosovë është në fuqi Rregullorja e UNMIK-ut numër 2008/22 për zbatimin e masave doganore lidhur me mallrat që i shkelin të drejtat e pronësisë intelektuale. Kjo rregullore nuk ka ofruar mbrojtje të mjaftueshme, të paktën me nevojat e kohës, për të drejtat e pronësisë intelektuale dhe nuk ka qenë në përputhje të plotë me Komisionin Evropian, përkatësisht me Rregulloren 1383/2003 dhe paraqet pengesë për Doganën për të vepruar konform mundësive dhe kapaciteteve që i ka zhvilluar.

Ai kërkoj nga deputetë që të votohet, në parim, Projektligji për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale

Kryesuesi ftoi kryetarin e Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa që ta marrë fjalën.

Pasi që nuk pati të paraqitur për fjalë nga komisioni funksional, kryesuesi hapi debatin për shqyrtim, në parim, të Projektligjit për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Nerxhivane Dauti**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Armend Zemaj**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Xhevdet Neziraj**,

në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Riza Smaka**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Synavere Rysha**, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar të “7+”, **Enis Kervan**, si dhe deputetja **Myzejene Selmani**, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----58,
Kundër-----2,
Abstenime-----1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Buxhet dhe Financa, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2008

Kryetari i njoftoi deputet se guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në pajtim me Ligjin për Bankën Qëndrore të Kosovës i ka paraqitur Kuvendit Raportin për vitin 2008.

Ai ftoi kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa që ta arsyetojë Raportin me Rekomandime.

Kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, **Gani Koci**, tha se Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Raportin Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2008, që si autoritet i pavarur i ka raportuar Kuvendit dhe theksoi se Komisioni ka rekomanduar që të ftohet guvernatori i Bankës së Republikës së Kosovës që ta arsyetojë Raportin e Bankës Qendrore.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e Raportit të Bankës Qendrore të Kosovës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë Raport dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Safete Hadergjonaj**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Armend Zemaj**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Shkumbin Demalijaj**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Myzejene Selmani**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Lulzim Zeneli**, si dhe deputetët: **Driton Tali**, **Naim Rrustemi**, **Ramadan Avdiu**, **Gjylnaze Sylja**, **Myrvete Pantina**, **Ardian Gjini**, **Naser Rugova**, **Riza Smaka**, **Besa Gaxherri**, **Kryetari i Kuvendit Jakup Krasniqi** dhe **Synavere Rysha**, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij Raporti. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----39,
Kundër-----31,
Abstenime-----4.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi Raportin e Bankës Qendrore të Kosovës me rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

6. Shqyrtimi i Projekt-strategjisë kundër korrupsionit për periudhën 2009-2011

Kryetari i njoftoi deputetët se Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me Ligjin kundër korrupsionit ka paraqitur për shqyrtim dhe miratim në Kuvend Projekt-strategjinë kundër korrupsionit për periudhën 2009-2011. Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës ka shqyrtuar Projekt-strategjinë kundër korrupsionit për periudhën 2009-2011 dhe ia ka rekomanduar për shqyrtim dhe miratim Kuvendit në seancë plenare, si dhe Komisioni për Buxhet e Financa, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës, ka shqyrtuar Projekt-strategjinë kundër korrupsionit për periudhën 2009-2011 dhe ka vlerësuar se nuk përmban implikime buxhetore shtesë.

Ai ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, si propozues, që ta marrë fjalën.

Zëvendëskryeministri **Ramë Manaj** tha se Qeveria e Republikës së Kosovës është e përkushtuar për luftimin e korrupsionit. Ky përkushtim është reflektuar edhe në Programin e punës së Qeverisë për periudhën 2008-2011 dhe në hapat konkretë që ka ndërmarrë dhe po ndërmerr Qeveria e Republikës së Kosovës në këtë drejtim. Qeveria në kontinuitet po mbështet iniciativat e ndërmarra të zhvilluara tashmë dhe po ndërmerr masa konkrete për të shtyrë përpara zhvillimin e mëtejshëm të infrastrukturës institucionale e ligjore në funksion të luftimit të dukurisë së korrupsionit në çdo fushë.

Ai tha se Draft-strategjia kundër korrupsionit për periudhën 2009-2011, e cila po paraqitet sot për miratim, synon të jetë një dokument që ofron hapa të nevojshëm që duhet ndërmarrë për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin në Republikën e Kosovës. Hartimi i Projekt – strategjisë kundër korrupsionit është bërë nën udhëheqjen e Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit dhe si projekt-dokument është pranuar nga Zyra e Kryeministrit, Zyra për Qeverisje të Mirë dhe grupi punues ndërministror, që e kanë analizuar këtë draft dhe kanë dhënë kontributin e tyre në finalizimin e këtij projekt dokumenti.

Zëvendëskryeministri **Manaj** ftoi deputetët që ta miratojnë Projekt-strategjinë kundër korrupsionit për periudhën 2009-2011, e cila parashtron qëllime të qarta dhe realiste, të cilat do të realizohen përmes masave konkrete legjislative institucionale dhe organizative që do të paraqiten në Planin e veprimit kundër korrupsionit.

Kryetari propozoi që koha e diskutimeve për kryetarët e komisioneve dhe shefat e grupeve parlamentare të jetë nga 10 minuta, kurse për deputetët 5 minuta

Kryetari hodhi në votim propozimin për kohën e diskutimeve. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ... shumica absolute,
Kundër.....3,
Abstenime.....0.

Kuvendi miratoi propozimin e Kryetarit për kohëzgjatjen e diskutimeve.

Kryetari ftoi kryetarin ose raportuesin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi ta marrë fjalën.

Kryetari i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, **Bahri Hyseni**, tha se komisioni e ka shqyrtuar me vëmendje Strategjinë antikorrupsion dhe me rastin e shqyrtimit të strategjisë kanë qenë të pranishëm edhe anëtarët e Qeverisë, por edhe njerëz që kanë ardhur nga antikorrupsioni për ta mbrojtur strategjinë para komisionit. Komisioni është pajtuar që të rekomandojmë në Kuvend që të aprovohet strategjia. Aspekti i parë është që ky dokument i plotëson të gjitha kriteret që të aprovohet si strategji. Aspekti i dytë është ndikimi pozitiv, sepse opinioni publik është njoftuar nga të gjitha institucionet për efektet negative që i ka korrupsioni në shoqëri. Aspekti i tretë është rëndësia e veçantë që iu ka kushtuar Agjencionit antikorrupsion që të forcohet me burime njerëzore, që të shtohet sado pak edhe buxheti, të bëhet trajnimi i njerëzve të cilët punojnë aktualisht në Agjencionin, duke lënë hapësirë që të bëjnë një punë të pavarur.

Ne emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa **Gani Koci** tha e kemi shqyrtuar këtë dokument edhe kemi ardhur në përfundim se si i tillë nuk ka implikime buxhetore. Ai theksoi se Strategjia kundër korrupsioni është shqyrtuar edhe me parë, por nuk ka kaluar në Komision për shkak se nuk ka pasur planin e veprimit, mirëpo tani, meqë është edhe plani i veprimit, i plotëson kushtet për aprovim.

Kryetari hapi debatin për Projekt-strategjinë kundër korrupsionit për periudhën 2009-2011.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projekt-strategji dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Ramadan Avdiu**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Kolë Berisha**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ardian Gjini**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Ibrahim Gashi**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Adem Salihaj**, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar të “7+”, **Xhezair Murati**, si dhe deputetët: **Naim Rustemi, Driton Tali, Gani Geci, Naim Maloku, Sanije Alijaj, Eset Cakolli, Mimoza Ahmeti, Naser Rugova, Gjylnaze Sylja, Hajdin Abazi, Besa Gaxherri, Riza Smaka, Donika Kadaj-Bujupi, Gani Buçinca, Drita Kadriu dhe Shkumbin Demalijaj**, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Pas këtyre diskutimeve, Kryetari e hodhi në votim miratimin e Strategjisë kundër korrupsionit për periudhën 2009-2011. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----36,
Kundër-----26,
Abstenime-----2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Strategjinë kundër korrupsionit për periudhën 2009-2011.

7. Debati për gjendjen tregtare në vend dhe raportet tregtare të Kosovës me shtetet e tjera

Kryetari njoftoi deputetët se Grupi Parlamentar i LDD-së, në pajtim dispozitat e Rregullores së Punës së Kuvendit ka kërkuar nga Kryesia e Kuvendit që në seancë plenare të debatohet lidhur me gjendjen tregtare në vend dhe raportet tregtare të Kosovës me shtetet e tjera.

Kryesia e Kuvendit, në pajtim dispozitat e Rregullores së Punës së Kuvendit e ka proceduar kërkesën në fjalë dhe ka kërkuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë një informatë me shkrim mbi gjendjen tregtare në vend dhe raportet tregtare të Kosovës me shtetet e tjera.

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Grupi Parlamentar të LDD-së për ta marrë fjalën.

Kryetari i Grupit Parlamentar të LDD-së, **Lulzim Zeneli**, tha se Grupi Parlamentar i LDD-së më 8 maj ka kërkuar nga Kryesia e Kuvendit që të radhitet kërkesa për debat lidhur me gjendjen tregtare në vend dhe raportet me shtetet tjera. Shqetësimi për gjendjen ekonomike, reformat e ngadalësuara, gjendja e rëndë energjetike, korrupsioni, mos transparenca e Qeverisë së Kosovës për shpenzimin e parasë publike janë vërejtje tejet serioze të Parlamentit Evropian të përfshira në Rezolutën e miratuar muaj më parë të vitit 2009. Po ashtu, edhe Banka Botërore i sugjeron Qeverisë së Republikës së Kosovës se Qeveria duhet të punojë në ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe individuale në eliminimin e burokracisë dhe raportet me investitorët.

Ai theksoi se qëllimi i Marrëveshjes së CEFTA-s ka qenë dhe mbetet krijimi i një tregu më të madh rajonal për bizneset kosovare, përmbushja e kriterëve që dalin nga Plani i Punës së Partneritetit Evropian, si dhe aspekte të tjera të rëndësishme, por siç shihet, po ndodh tek ne e kundërta, si pasojë e një qasje joserioze, si pasojë e një qasje joprofesionale dhe kryesisht e bazuar në raporte të jashtme.

Ai theksoi se Grupi Parlamentar i LDD-së vlerëson se Republika e Kosovës ka nevojë për një rishqyrtim të marrëdhënieve ekonomike në mes të këtyre dy vendeve në mënyrë që të krijohet një partneritet i qëndrueshëm dhe jo të kemi marrëdhënie të thjeshta tregtare. Duke pasur parasysh supermacinë e Qeverisë së Republikës së Kosovës në raport me Kuvendin, si institucioni më i lartë i vendit, duke qenë të vetëdijshëm për pamundësinë e Kuvendit të Republikës së Kosovës për të ndikuar në kursin e politikave qeveritare, konsiderojmë dhe besojmë se ky debat së paku do të trokas në ndërgjegjen e Qeverisë duke bërë me dije se është momenti i fundit që Republika e Kosovës të krijojë politika shtetërore në mbrojtje të interesit të qytetarëve të vendit, në mbrojtje të prodhuesit dhe fermerit kosovar.

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë **Lutfi Zharku** tha se ekonomia kosovare ka shënuar rritje që nga viti 1999. Gjatë këtyre viteve janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm makro - ekonomikë për ngjalljen e ekonomisë kosovare, mirëpo sfidat mbesin ende të shumta si në

aspektin ekonomik, ashtu edhe në atë social. Institucionet e Kosovës janë të vetëdijshme se ndryshimi i këtij realiteti kërkon qasje dhe reforma gjithëpërfshirëse ekonomike dhe politike në mënyrë që të ndryshohet mjedisi operues në Kosovë me qëllim të përmirësimit të pozitës konkurruese të Kosovës në tregun botëror. Ky raportim bazohet pjesërisht në dy raportet e fundit përshkruese të tregtisë ndërkombëtare të Kosovës. E para, përshkruan rrjedhat e tregtisë së jashtme në vitin 2008, ndërsa tjetra paraqet raportet e tregtisë së jashtme për gjashtëmujorin e parë të vitit 2009. Sa i përket tregtisë me vendet e CEFTA-s në periudhën e lartpërmendur, në këtë vit shënojmë eksportet e para drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës që nga mbarimi i luftës. Për gjashtë muajt e parë të vitit 2009, janë eksportuar 4.6 milionë euro, që përbëjnë mbi 7% të totalit të eksporteve të Kosovës.

Ministri Zharku theksoi se që nga fillimi kemi qenë të përkushtuar për zgjidhjen apo përdorimin e masave kundër balancuese, si shenjë e përkushtimit të Kosovës për respektim të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe të aspiratave tona për liberalizim të plotë dhe anëtarësim në OBT.

Kryesuesi hapi debatin lidhur me gjendjen tregtare në vend dhe raportet tregtare të Kosovës me shtetet e tjera.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë: Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Safete Hadergjonaj**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Lutfi Haziri**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ethem Çeku**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së **Myzejene Selmani**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Besa Gaxherri**, si dhe deputetët: **Lujeta Shehu**, **Gjylnaze Sylja**, **Myrvete Pantina**, **Berat Luzha**, **Driton Tali** dhe **Naser Rugova**, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse i këtij procesverballi.

Në fund, në emër të parashtruesit të mocionit, **Lulzim Zeneli**, përmbylli debatin duke konstatuar se qëllimi i këtij debati është se Qeveria duhet të japë përgjigje se cilat janë masat konkrete që duhet marrë në raport me gjendjen tregtare në vend dhe shtetet e tjera,

Ai vuri në dukje disa çështje të cilat duhet të adresohen nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

E para, ka të bëjë me zbatimin e parimit të reciprocitetit me të gjitha ato vende të cilat po e bllokojnë depërtimin e prodhimeve kosovare.

Të rinegociohet marrëveshja në mënyrë të veçantë me të gjitha vendet me të cilat për momentin ekzistojnë raportet e disfavorshme të debalancuara në raport me Kosovën dhe

Të vendoset në kontroll të plotë pika 1 dhe 31 kufitare, në mënyrë që të ndërpriten një herë e përgjithmonë trafiqet ilegale, të cilat po e dëmtojnë buxhetin e Kosovës dhe po e dëmtojnë ekonominë kosovare.

Kryetari i shtyri punimet e seancës për ditën e nesërme.

E martë, 13 tetor 2009
Vazhdimi i seancës

8. Shqyrtimi i Raportit për monitorimin e Ligjit për mbeturina

Kryetari ftoi kryetarin ose përfaqësuesin a raportuesin e Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor që ta marrë fjalën.

Berat Luzha tha se Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, në kuadër të fushëveprimit të vet ka mbikëqyrur zbatimin e Ligjit për mbeturina dhe ka identifikuar problemet mjedisore. Me qëllim të mbledhjes së të dhënave për lartësinë e zbatimit të ligjit, Grupi punues ka zhvilluar veprimet e nevojshme, vizita nëpër komuna, vizita në ndërmarrjet publike, takime pune me strukturat komunale, dëgjim publik kuvendor, grumbullim materialesh nga qarqet e interesuara .

Ligji për mbeturina është i mirë përgjithësisht, por i paqartë në disa pjesë dhe në masë të madhe i pazbatueshëm. Nuk përcaktohet saktë roli dhe përgjegjësia e komunave, madje mund të themi se komunat nuk kanë fare kompetenca dhe përgjegjësi për mbrojtjen e mjedisit jetësor. Ai theksoi se Ligji paraqet hallka të shkëputura në relacionet qytetar-ndërmarrje publike - deponi, Zyra e Rregullatorit – Ministri apo Qeveri.

Ministri **Mahir Jagcillar** përgëzoi Komisionin për punën e bërë dhe sugjerimet dhe tha se rekomandimet e Komisionit do t'i marrin parasysh, se gjendja e mbeturinave në Kosovë është rezultat i konsumimit të popullsisë, të numrit të shtëpive dhe të vendbanimeve në Kosovë. Në Kosovës infrastruktura e klasifikimit të mbeturinave është jo e mire dhe e ulët si rezultat i gjendjes ekonomike në vend dhe i inkasimit të ulët të taksave për mbeturina. Në Kosovës sasia e mbeturinave është ende e madhe dhe sa vjen e shtohet, por ministria është duke i realizuar disa projekte të mëdha në këtë fushë.

Kryesuesi hapi debatin lidhur me Shqyrtimin e raportit për monitorimin e Ligjit për mbeturina.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë Raport dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Elheme Hetemi**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Armend Zemaj**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Naim Maloku**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Heset Cakolli**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Lulzim Zeneli**, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar të “7+”, **Shpresa Murati**, si dhe deputetët: **Bahri Hyseni**, **Sala Berisha-Shala**, **Gjylnaze Syla**, **Riza Smaka**, **Berim Ramosaj**, **Eqrem Kryeziu**, **Ahmet Isufi**, **Mahir Jagcillar**, **Ibrahim Makolli**, **Vezira Emrush** dhe **Arsim Rexhepi**, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Kryesuesi e hodhi në votim Raportin e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural Mjedis dhe Planifikim Hapësinor për zbatimin e Ligjit për mbeturina.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----80,
Kundër-----1,
Abstenime-----0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi raportin e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor për zbatimin e Ligjit për mbeturina.

9. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit ad-hoc për emërimin e anëtarëve të Bordit të Radio-Televizionit të Kosovës

Kryesuesi ftoi Kryetarin e Komisionit parlamentar ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radio-Televizionit të Kosovës, që ta marrë fjalën.

Hajredin Kuçi tha se Komisionit parlamentar ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radio-Televizionit të Kosovës ka mbajtur gjithsej pesë mbledhje me radhë dhe e ka dërguar Raportin me rekomandime në Kuvend. Ne kemi marrë listën me 18 kandidatë dhe kemi kërkuar listën me plotësim nga komuniteti jo shumicë në Kosovë dhe kemi premtuar se lista me emrat e anëtareve të Bordit të RTK-së do të dorëzohet në Kuvend deri para datës 15 tetor 2009.

Kryetari hapi debatin lidhur me emërimin e anëtarëve të Bordit të Radio - Televizionit të Kosovës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë Raport dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Ramë Buja**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Lutfi Haziri**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Donika Kadaj-Bujupi**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Esat Brajshori**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Lulzim Zeneli**, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar të “7+”, **Xhezair Murati**, si dhe deputeti **Numan Baliq**, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Kryetari hodhi në votim emërimin e anëtarëve për Bordin e Radio - Televizionit të Kosovës. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----61,
Kundër-----11,
Abstenime-----5.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Për emërimin e anëtarëve të Bordit të Radio - Televizionin e Kosovës

I. Anëtarë të Bordit të Radio - Televizionit të Kosovës emërohen:

1. Ali Podrimja,
2. Arif Bozaxhi,
3. Aleksandar Janiçeviq,
4. Avni Abazi,
5. Lindita Tahiri,
6. Naime Beqiraj,
7. Rrahman Paçarizi,
8. Shemsi Sylja, dhe
9. Shukrije Gashi.

- II. Mandati i anëtarëve të Bordit të Radio – Televizionit të Kosovës bëhet në pajtim me nenin 23.4 të Ligjit për Radio - Televizionin e Kosovës.
- III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Kuvendit.

10. Njoftimi me vendimin e Grupit Parlamentar të AKR-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare

Kryetari i njoftoi deputetët se Grupi Parlamentar i AKR-së ka vendosur që anëtar në Komisionin për Punë të Brendshme dhe Siguri, në vend të deputetit Shkumbin Demaliaj, të emërohet deputetja Suzana Novoberdaliu dhe në Komisionin për Buxhet dhe Financa, në vend të deputetit Riza Smaka, të emërohet deputetja Suzana Novoberdaliu.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi vendosi që deputetja **Suzana Novoberdaliu** emërohet anëtare në komisionin për Punë të Brendshme dhe Siguri, nga GP AKR-së, kurse në vend të deputetit Riza Smaka emërohet anëtare në Komisionin për Buxhet dhe Financa, po ashtu nga GP, AKR-së, **Suzana Novoberdaliu**.

Seanca i përfundoi punimet në orën 13: 05 minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: **Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale**